



Nr. Prot. 4813
Dt. 16.10.2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
PREFEKTI I QARKUT KORÇË

Shkruar: Kërkim
Shtetërore
Referencë 16.10.2024

Nr. 988/11 Prot.

Korçë, më 15.10.2024

Lënda : Mbi bazueshmërinë ligjore të akteve të Këshillit

KËSHILLIT TË BASHKISË KOLONJË

KRYETARIT TË BASHKISË KOLONJË

Mbështetur në ligjin nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", i ndryshuar, pas verifikimit të vendimeve nr. 87, nr. 88, nr. 89, nr. 91 dhe nr. 94 datë 27.09.2024, të Këshillit të Bashkisë Kolonjë, **konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tyre**, bazuar në nenin 8, pika 2, nenin 9, pika 1, nënpika 1.1, gërma "b", nenin 28, nenin 54, 55 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, nenin 32, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", i ndryshuar, udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 3, datë 28.02.2024 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2025-2027", vendimin e Këshillit të Bashkisë Kolonjë nr. 154, datë 20.12.2023 "Për miratimin e kalendarit për programin buxhetor afatmesëm 2025-2027 dhe buxhetin vjetor 2024", vendimin e Këshillit të Bashkisë Kolonjë nr. 7, datë 24.01.2024 "Për miratimin e raportit të vlerësimit dhe parashikimit afatmesëm të të ardhurave 2025-2027", vendimin e Këshillit të Bashkisë Kolonjë nr. 70, datë 19.07.2024 "Për miratimin e tavaneve buxhetore përfundimtare të programit buxhetor afatmesëm vendor 2025-2027 të Bashkisë Kolonjë", ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për Funkcionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike", ligjin nr. 57/2020 "Për pyjet", vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 433, datë 8.6.2016 "Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-Komunave/Bashkive", i ndryshuar, vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 559, datë 29.07.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike dhe prodhimet drusore e jodrusore pyjore, si dhe mënyrën e procedurës së mbledhjes së tyre", të ndryshuar udhëzimin e Ministrisë së Mjedisit nr. 1, datë 09.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit dhe të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor", ligjin nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, ligjin nr. 44/2015 "Kodi procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, ligjin nr. 97/2023 "Për buxhetin e vitit 2024", i ndryshuar, udhëzimin plotësues të Ministrisë së Financave nr. 1, datë 24.01.2024 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2024", udhëzimin nr. 2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar.

Shënim: Lidhur me vendimin nr. 87, datë 27.09.2024 të Këshillit të Bashkisë Kolonjë, insitucioni i Prefektit të Qarkut Korçë, sjell në vëmendje zbatimin e afateve kohore sipas përcaktimit të pikës 34, të udhëzimit plotësues nr. 3, datë 28.02.2024 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2025-2027".

Në lidhje me vendimet nr. 95, nr. 96, nr. 97 datë 27.09.2024 të Këshillit të Bashkisë Kolonjë, institucioni i Prefektit të Qarkut Korçë nuk i konsideron aktet me karakter normativ, për pasojë shqyrtimi i ligjshmërisë së tyre del jashtë kompetencave të dhëna me ligj.

